



Përditësim për shtypin

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Kryetarja e Dhomave të Specializuara, gjykatëse Ekaterina Trendafilova, më 11 dhjetor 2025 vendosi të mos ulë ose modifikojë dënimin e z. Haxhi Shala, i cili ka kryer dy të tretat e tij.

Kujtojmë se Haxhi Shala, Sabit Januzi, dhe Ismet Bahtijari pranuan fajësinë për një akuzë për pengim të procesit dhe një akuzë për frikësim në lidhje me një dëshmitar të Dhomave të Specializuara. Dy të akuzuarit pranuan se ishin pjesë e një grupi që u përpoq të nxiste këtë person që të mos jepte dëshmi përpara Dhomave të Specializuara, përmes premtimit për përfitim.

Në vendimin e saj mbi dënimin e z. Shala, Kryetarja e DHSK-së vuri në dukje se z. Shala nuk ka shprehur pendim në asnjë prej mundësive që iu dhanë për këtë, për shembull gjatë seancës mbi pranimin e fajësisë ose në parashtrimet me shkrim lidhur me dënimin e tij.

Sipas ligjit, kur personi i shpallur fajtor ka vuajtur dy të tretat e dënimit, ai ose ajo plotëson kriterin për shqyrtimin në lidhje me uljen, modifikimin ose ndryshimin e dënimit. Ky vendim merret nga Kryetarja e Dhomave të Specializuara në konsultim me gjykatësit e Dhomave të Specializuara, duke u bazuar në interesin e drejtësisë dhe parimet e përgjithshme juridike. Nuk ekziston e drejtë automatike për ulje, modifikim ose ndryshim, pas vuajtjes së dy të tretave të dënimit.

Në vendimin e saj të fundit, Kryetarja e DHSK-së bëri me dije gjithashtu se do të shqyrtojë modifikimin e mundshëm të dënimit të z. Shala pas dy muajsh, pas marrjes së një raporti të mëtijshëm nga Zyra Administrative, përfshirë në lidhje me distancimin e mundshëm, të qartë dhe të njëmendte, nga vepra penale për të cilën z. Shala u shpall fajtor.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, dëshirojmë t'i kujtojmë publikut se deklaratat përmbyllëse janë planifikuar të paraqiten nga data **9 deri më 13 shkurt 2026.**

Kujtojmë se në aktakuzën e konfirmuar janë ngritur akuza për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Në aktakuzë, Prokuroria pretendon se të akuzuarit janë individualisht përgjegjës për rrëmbimin, keqtrajtimin dhe vrasjen e qindra civilëve dhe personave që nuk kanë marrë pjesë në luftime. Viktimat e pretenduara ishin persona që konsideroheshin kundërshtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ndër ta, pretendohet se ishin persona të cilët perceptoheshin si bashkëpunëtorë të forcave jugosllave dhe kundërshtarëve politikë. Të akuzuarit janë deklaruar të pafajshëm për të gjitha akuzat.





Gjatë deklaratave përmbyllëse, Prokuroria dhe Mbrojtja paraqesin një përmbledhje të argumenteve të tyre. Mbrojtja e Viktimave shpjegon ndikimin e krimeve të pretenduara tek viktimat.

Pas kësaj, Trupi Gjykses do të mbyllë çështjen gjyqësore dhe do të vijojë me kuvendimet për nxjerrjen e aktgjykimit.

Gjykatësit do të vlerësojnë me kujdes besueshmërinë e dëshmitarëve, mbështetshmërinë dhe peshën e dëshmive të dëshmitarëve, dhe secilën provë.

Aktgjykimi duhet të shpallet brenda 90 ditësh nga mbyllja e çështjes gjyqësore. Në rast se rrethanat kërkojnë kohë shtesë, ky afat mund të zgjatet me 60 ditë.

Gjykimet në Dhomat e Specializuara të Kosovës kryhen nga gjykatësit në përputhje të plotë me ligjin dhe standardet më të larta të drejtësisë ndërkombëtare. Të pandehurit mund të apelojnë vendimet e një trupi gjykses para një trupi gjykses të dytë dhe ndonjëherë para gjykatësve të nivelit të tretë. Më tej, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese ofron të pandehurve mbrojtje të mëtejshme të të drejtave të njeriut.

Të gjithë të akuzuarit prezumohen të pafajshëm, përveç nëse prokuroria vërteton fajësinë e tyre jashtë dyshimit të arsyeshëm.

Sa i takon pikës konkrete të paraburgimit të të akuzuarve në këtë çështje gjyqësore, është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se një person mund të mbahet në paraburgim vetëm nëse gjykatësit konstatojnë ekzistencën e rreziqeve konkrete të cilat nuk mund të zvogëlohen jashtë paraburgimit. Çdo dy muaj, Gjykatësit vlerësojnë nëse paraburgimi vijon të jetë i domosdoshëm dhe i përligjur, mbështetur në informacionin që ata kanë kur bëjnë këtë vlerësim.

Deri tani, në më shumë se 25 rishikime të paraburgimit, gjykatësit kanë konstatuar se z. Thaçi dhe të bashkakuzuarit e tij paraqesin rrezik të kryerjes së veprave penale të tjera, ne veçanti kundër personave që kanë dhënë dëshmi ose që do të japin dëshmi para Dhomave të Specializuara. Gjykatësit kanë theksuar gjithashtu se paraburgimi synon të parandalojë rrezikun e hakmarrjes kundër dëshmitarëve ose përpjekjet për të nxjerrur një dëshmitar që të tërheqë dëshminë e tij.

Pushimi dimëror i gjykatës fillon më 22 dhjetor 2025 dhe zgjat deri më 9 janar 2026. Gjatë kësaj periudhe nuk do të mbahen seanca, por aktivitetet e tjera të gjykatës do të vijojnë pa ndërprerje.

Informimi vijues për shtypin përmes internetit do të mbahet më 15 janar në orën 2:30 pasdite.

